



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 201, Datë 02.12.2020

MBI

**RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “GSA” SH.P.K., ME NR. 321, seria T11/15, NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2 gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “e”; nenit 5, pika 1, gërma “e”; nenit 8, nenit 9, nenit 13, dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, si dhe nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 02.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 125/1 Prot, datë 27.11.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, për rinovimin e licencës së shoqërisë “GSA” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 181, datë 06.11.2020, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “GSA” sh.p.k., nr. 321, Seria T11/15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s Nr. 57, datë 22.06.2011 dhe rinovuar me vendimin nr. 160, datë 28.12.2015.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në median e shkruar me shkresën nr. 62/34 prot, datë 09.11.2020 dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “GSA” sh.p.k..
- Me shkresën nr. 1184 prot, datë 09.11.2020, ERE i’u drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.
- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “GSA” sh.p.k. me shkresën nr. 1184/1 prot, datë 17.11.2020, ka përcjellë dokumentacionin e munguar.
- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar. Në datën 30.06.1993, është e rregjistruar pranë QKB, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k).

- Shoqëria “GSA” sh.p.k., është mbajtëse e licencës nr. 321, Seria T11/15, së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike që prej datës 22.06.2011, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 57, me afat vlefshmërie deri në datën 22.06.2016, të rinovuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 160, datë 28.12.2015, për pesë vjet të tjera.
- Shoqëria “GSA” sh.p.k, ka aplikuar brenda afatit ligjor të nevojshëm për rinovimin e licencës.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për rinovimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike, si dhe ka kryer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Aplikimi i shoqërisë “GSA” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “*Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*”, të ndryshuar, si më poshtë:

- Format i dhe dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të rinovojë licencën nr. 321, seria **T11/15**, të shoqërisë “GSA” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s **nr. 57, datë 22.06.2011, i ndryshuar**, për një afat 5-vjeçar (pesë), duke filluar nga data 23.06.2021.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqytjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI